



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 95 / 2020

Datë: 08 / 11 2020

Në mbështetje të nenit 9, (paragrafi 2), nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - nr. 07/2020, si dhe nenit 24/B, (paragrafi 4) të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. SHFUQIZOHET Vendimi nr. 96/2018 i datës 23.11.2018 për emërimin e Z. Driton Lajçi, Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

A r s y e t i m

Bazuar në email-in e datës 26.10.2020 lidhur me njoftimin për përfundimin e angazhimit/emërimit në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, me arsyetimin e kthimit në marrëdhënien e punës në Telekomën e Kosovës ku dhe ishte i punësuar që nga data 20.12.2005 dhe kishte të pezulluar përkohësisht të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës me dt. 30.10.2019.

Andaj, në nenin 8, (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - nr. 07/2020, si dhe nenit 24/B (paragrafi 4) të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Driton Lajçi;
- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.